

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"INVEST1 GROUP "sh.p.k
KREU I
(DISPOZITA TE PERGJITHSHME)
FORMIMI I SHOQERISE

NENI 1

a. Sot në Vlore në datën 11 Shkurt 2021 në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008" Për tregtarët dhe shoqërite tregtare" themelohet shoqëria tregtare me përgjegjesi të kufizuar e emërtuar "INVEST1 GROUP " shpk, me vullnetin e lirë të ortakëve të saj,

Z. Migen Xhelo, shtetas shqiptar lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë mbajtës i kartës së identitetit me numër I51203053D dhe Ortaku, Z. Resadri Calaj, shtetas shqiptar lindur në Vlore dhe banues në Vlorë mbajtës i kartës së identitetit me numër I51203053D

b. të cilët me vullnetin e tyre të lirë dhe në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregëtare", si dhe Aktin e Themelimit, kanë vendosur të hapin këtë shoqëri, me qëllim që të përfitojnë të ardhurat që mund të vijnë nga veprimtaria private e Shoqërise, si dhe të përballojë humbjet der në kufirin e vlerës së kontributit në Kapitalin Themeltar.

c. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në bazë të ekonomisë së tregut të lirë.

Shoqëria tregtare "INVEST1 GROUP" shpk., fiton Personalitet Juridik nga dita e rregjistrimit të saj pranë zyrës së Qendrës Kombëtare të Biznesit.

FORMA DHE EMERTIMI I SHOQERISE

NENI 2

1. Shoqëria është e organizuar si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar.

2. Emertimi i Shoqërise është: "INVEST1 Group "shpk.

3. Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare, mund të ruhet i njëjti emertim, me kusht që Personat Juridik të shtojnë në këtë emertim një shenim i cili ka të bëjë me transferimin.

SELIA E SHOQERISE NENI 3

1. Shoqëria tregëtare "INVEST1 Group shpk. ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë, Rr: "Kosova", pranë Qendrës Tregëtare Riviera Vlorë.

2.. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi apo agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

3. Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4. Njësitë strukturore të shoqërisë në format e mësipërme do të krijohen në përputhje me legjislacionin Shqiptar kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendrën e tij.

5. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

KOHZGJATJA

NENI 4

1. Shoqëria Tregtare " INVEST1 GROUP" shpk., do të përmbushë objektin e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një Personaliteti të ri Juridik.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 5

Objekti i shoqërisë " INVEST1 GROUP" shpk do të jetë:

Shoqëria do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj; aktivitetet e mëposhtëme:

- ndërmjetësim në shitblerjen e pasurive të paluajtshme dhe dhënie/marrje me qera të objekteve të ndryshme,

-konsulencë për investime, ndërmjetësim midis investitoreve të ndryshëm të cilët kanë si qëllim investimet: të vogla, të mesme dhe investime strategjike ku kompania jonë do të bëjë ndërmjetësimin që palët të lidhen për të finalizuar marrëveshje.

-Rikonstrukcion të objekteve në bashkëpunim me partnerët tanë eksperte Ndërtimi, Arkitekt dhe Vlerësues të licensuar.

- tregëti me pakicë e shumicë e materialeve të ndërtimit dhe industriale

TE DREJTAT E SHOQERISE

NENI 6

Shoqëria tregtare "INVEST1 Group" shpk., nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale që ortaku zhvillon në mënyrë të pavarur prej saj. Shoqëria mund të ndryshojë emrin, seline, kohëzgjatjen, objektin e veprimtarisë, administratorin, sipas vendimeve që do të marrin ortakët e saj.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 7.

Kapitali themeltar i shoqërise përbëhet nga 100.000 leke (njëqind mijë lek), i cili është terësisht kapital financiar. Kapitali themeltar është i ndarë në 2 kuot me vlerë

nominale 100.000 lekë (njëqind mijë), 1 kuote ne masen (50%) me vleren 50.000 Leke (pesedhete mije) z. Migen Xhelo, 1 kuote ne masen (50%) me vlere 50.000leke (pesedhete mij) z. Resadri Calaj

Kapitali themeltar zotërohet 100 % nga ortakët e saj, z. Migen Xhelo dhe z. Resadri Calaj

NENI 8

Shoqëria krijon fondin rezerve dhe fonde të tjera të veçanta të financimit për zhvillimin ekonomik e tregtar.

NENI 9

1. Përbërja e kapitalit të shoqërise, fondet e krijimit të saj si dhe përdorimi e rregullimi i çdo fondi të veçantë përcaktohen nga Ortakët sipas të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në statut.
2. Të ardhurat e përgjithëshme të shoqërise dhe në përgjithësi çdo operacion financiar i saj do të pasqyrohet në kontabilitetin e shoqërise sipas legjislacionit në fuqi dhe në mbështetje të akteve përkatëse të rrjedhura prej tij.

NENI 10

1. Shoqëria Tregëtare "INVEST1 Group" shpk., është pronare e pasurisë së saj të cilën e përdor dhe e disponon në emer të saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë.
2. Shoqëria është e lirë të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar.
3. Të gjitha shpenzimet për ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistencë teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqërisë.

NENI 11

1. Pasuritë e shoqërise vleresohen në monedhe shqiptare.
2. Aktiviteti financiar i shoqërise do të mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti dhe pasqyrat financiare do të miratohen brënda gjashtë muajve të vitit në vazhdim.
3. Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta të hartuara nga Ortakët dhe nëse e kërkon ligji nga eksperti kontabël i autorizuar miratohen me Vendim të Ortakeve të saj.

NENI 12

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore midis bashkëshorteve si dhe ndërmjet pasardhesve dhe paraardhësve.

NENI 13

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgimi ose brenda familjes personave përfitues do të bëhet pasi ata të pranojnë përmbajtjen e statutit të kësaj shoqërie tregtare me gjithë ndryshimet që ai mund ketë pësuar dëme në momentin që këto pjese të kapitalit themeltar bëhen të transferueshme.

NENI 14

Kuotat e kapitalit të shoqërisë "INVEST1 GROUP" shpk, e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

kontributit në kapitalin e shoqërise; shitblerjes;

trashëgimise;

dhurimit

ose çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Kalimi i kuotave, miratohet nga ortakët e shoqërisë.

NENI 15

Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributeve në para dhe në natyre apo / zvogëlimi bëhet me Vendimin e Ortakëve të shoqërise mbi bazën e një projekti të paraqitur nga eksperti kontabël i miratuar.

KREU I DYTE (ORTAKET)

NENI 16.

Ortakët e shoqërise tregtare "INVEST1 Group" shpk., gëzojnë të gjitha të drejtat dhe marrin përsipër detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, në Aktin e Themelimit dhe në Statutin e Shoqërisë.

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

NENI 17.

1. Të paraqesin pyetje me shkrim në lidhje mbi aktivitetin dhe administrimin e shoqërise ndaj administratorit;
3. Të informohen mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventarët dhe llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabel;
4. Të përfitojnë nga fitimi i shoqërisë;
5. Të kërkojnë prishjen e shoqërise në rrethana të caktuara;
6. Të hartojnë e miratojnë ndryshimet në Statut;
7. Të miratojnë bilancin vjetor të shoqërisë
8. Të vendosin për zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
9. Të emerojnë edhe shkarkojnë administratorin e shoqërisë;
10. Të shpallë prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqërisë;
11. Të shprehen për kohëzgjatjen e shoqërisë;
12. Të miratojnë marrëveshjet e arritura në qarkullimin civil të saj;
13. Të miratojnë strukturat e shoqërisë etj.;
14. çdo vendim tjetër qëi njihet nga ligji, Akti i themelimit të shoqërise dhe Statutit të saj.

15. Proces verbalet e mbledhjeve ruhen në seline e shoqërisë

KREU I TRETË

(DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË)

NENI 18.

1. Ortakët janë organi më i lartë vendimmarres ishoqërisë.
2. Ortakët mund t'i delegojnë kompetencat e tyre me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
3. çdo klauzole e kundërt është e pavlefshme në këtë rast.

ADMINISTRATORI

NENI 19.

1. Ortakët emërojnë administrator dhe drejtues teknik , të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa revokohen nga shoqëria ose largohen me dëshirën e tyre.
2. Administratori i Shoqërisë do të jetë z. Migen Xhelo, i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët për një periudhë 5 (pesë) vjeçare dhe me të drejtë rizgjedhje Administratori i emëruar i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë me përjashtim të rasteve të veçanta që ligji i jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.
3. Administratori mund ti delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
4. Shoqëria në të ardhmen mund të administrohet dhe nga një administrator tjetër, i cili emërohet me Vendim të Ortakëve.

TE DREJTAT E ADMINISTRATORIT

NENI 20.

Administratori ka këto të drejta:

1. Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet e saj me të tretët, e në administratën publike;

2. Të emerojë pranë shoqërise personelin e domosdoshëm që i nevojitet asaj në përmbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;
3. Të paraqesë për miratim të Ortakëve strukturën e brendshme organizative të shoqërise me emra përkates dhe të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni i punës i Republikës së Shqipërisë;
4. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë brenda kufijve të caktuara nga Ortakët;
5. Të testojë aftësite e punonjësve në administratë;
6. Të hartojë objektivat e shoqërisë për çdo vit pasues dhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Vendimet e mara nga Ortakët;
8. Të hartoj planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqesë ato për miratim nga Ortaket e shoqërisë.

NENI 21

Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vete shoqërise ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 22

1. Shoqëria organizon kontrollin e brëndshëm me ekonomist të liçensuar dhe kur kërkohet nga ligji me një ekspert kontabël të autonëizuar, te cilët janë përgjegjës për problemet që mund tëshkaktojnë nga mos kryerja në rregull e detyrës së tyre.
2. Për emërimin, kompetencat, detyrimet, përgjegjësite, zëvendesueshmërine, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimin e tij zbatohet legjislacioni Shqiptar në fuqi.

NENI 23

1. Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këte flishe.
2. Marrja në punë bëhet me rregjistrimin nga punëdhënësi në Librin e Punës së Shoqërisë, si dhe duke njoftuar organet e Punës së Juridiksionit ku ushtron aktivitetin Shoqëria.

3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës, bëhet në baze të një akti me shkrim të lëshuar nga Administratori.

Largimi lidhet me mbarimin e kontratës së punës për shkak të shkeljeve disiplinore ose me kërkesën e të interesuarit.

2. Mosmarreveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim të palëve, të cilat për këtë qëllim mund të caktojnë nga një përfaqësues me prokurë. Kur mirëkuptimi nuk është i mundur, palët i drejtohen Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Vlorë,

FORCAT MADHORE

NENI 24

Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi kur ka paaftësi paguese pjesore apo të plotë për kryerjen e detyrimeve të tij kur kjo është si pasojë e rrethanave të forcave madhore. Ngjarje të forcave madhore janë ato që i shpëtojnë kontrollit të ortakut.

Kur ortakut ndodhet në paaftësi të plotësoj detyrimet e tij për arsyet e forcave madhore, në bazë të kontratës dhe statutit duhet të bëjnë cdo përpjekje që ta kapërcejnë këtë vështirësi.

SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 25

Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë në cdo kohë dhe për çfarëdo shkak.

Shoqëria mund të priset para kohe;

- Me vendim të ortakëve të vetëm të saj.

- Kur mbaron kohëzgjatja e shoqërisë.

- Pas dy vjeteve të veprimtarisë me bilance negative (Humbje).

— Me vendim të gjykatës ose për arsye të tjera të parashikuara në statut.

Në rast mbyllje ortakët vendosin mbi mënyrat e likuidimit dhe caktojnë një ose më shumë likuidatore duke ju percaktuar dhe detyrat.

Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shenimi "Shoqëri në likuidim".

Mbasi bëhet njoftimi i mbylljes së likuidimit dhe kryen formalitetet e duhura, shoqëria

çregjistrohet nga regjistri tregtar i Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

BAZA LIGJORE NENI 26

E gjithë veprimtaria e shoqërise do të bazohet në ligjin 9901 date 14.04.2008” Për tregtarët dhe shoqërite tregtare” si dhe në përgjithësi në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 27

Për sa nuk është parashikuar në këtë Akt Themelimi dhe Statut do të aplikohet Ligji

“Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregëtare” si dhe Legjislacioni Shqiptar në fuqi.

NENI 28

Ky Akt Themelimi dhe Statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Rregjistrin Tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit në Tiranë.

NENI 29

Ky Akt Themelimi dhe Statut përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKET

MIGEN XHELO



RESADRI GALAJ

